

VENDIM
Nr. 499, datë 10.6.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE
SHOQËRISË “MSP TRADE CONCEPT”, SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË
“ISH-NPV Nr. 2, DURRËS” NË “NPV”, SHA, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “M.S.P. Trade Concept”, sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Ish-NPV nr. 2, Durrës”, në “NPV”, sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 7 132 (shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e dy) m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 4 240 (katër mijë e dyqind e dyzet) m², sipas genplanit objekt nr. 1 (3 kate), 4 082 (katër mijë e tetëdhjetë e dy) m² + objekt nr. 1/a, 7 (shtatë) m² + objekt nr. 1/b, 3 (tre) m² + objekt nr. 2, 126 (njëqind e njëzet e gjashtë) m² + objekt nr. 3, 22 (njëzet e dy) m², si dhe sipërfaqe funksionale 2 892 (dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ADMINISTRATIVE
GEOMETRY

[illegible]

Admission
Genie 0.1A

AUTOMATED REGISTRATION

NEW "NEW" Client

STATUS: REGISTERED

NAME: JOHN DOE

DATE OF BIRTH: 1990-01-01

SEX: Male

DATE OF REGISTRATION: 2020-01-01

REGISTER

INDONESIA

